

Shoqata e Kontabilistëve të Çertifikuar dhe Auditorëve të
Kosovës

Society of Certified Accountants and Auditors of Kosovo

**Modul 1 - Lënda
Parakualifikuese**

M1

Nr.

FLETË PROVIMI
Exam Paper

Udhëzime/Instructions:

1. MOS E HAPNI DERISA T'JU LEJOHET PREJ
MBIKËQYRËSIT
Do Not Open Until Your invigilator Allows You to Do So.
2. ËSHTË E DETYRUESHME PËRGJIGJA E GJITHA PYETJEVE
All Questions Are Mandatory
3. KOHA E LEJUAR ËSHTË 3 ORË
Time Allowed is 3 Hours
4. EMRI JUAJ NUK DUHET TË PARAQITET NË ASNJË FLETË TË
KËTIJ PROVIMI.
Your name should appear nowhere in this test.

Data 07.07.2018

CONTENT / PËRMBAJTJA

Pjesa	Maksimumi i Dhënë	-Kujdes! Kjo pjesë është vetëm për përdorim nga ShKÇAK- PIKËT E DHËNA
Pjesa 1	25	
Pjesa 2	25	
Pjesa 3	25	
Pjesa 4	25	
Total	100	

1. Një bilanc vërtetues dëshmon se libri kryesor është i saktë.
 - A. E saktë
 - B. **E pasaktë**

(1 pikë)

2. Dividentat e deklaruara të aksioneve raportohen në pasqyrën e rrjedhjes së parasë së gatshme si:
 - A. Aktivitete financuese
 - B. Aktivitete investuese.
 - C. Aktivitete jo në para të gatshme.
 - D. **Nuk raportohen në pasqyrën e rrjedhjes së parasë së gatshme.**

(1 pikë)

3. Sipas kontabilitetit të bazuar në para të gatshme, të hyrat njihen vetëm atëherë kur:
 - A. Shërbimet janë kryer.
 - B. Të hyrat janë fituar.
 - C. **Paraja është pranuar.**
 - D. Të hyrat janë akruar (përlllogaritur).

(1 pikë)

4. Lajmi Press ka pasur stoqet e furnizimeve në fillim €400, ka blerë €550 të furnizimeve gjatë periudhës, dhe ka pasur stoqe përfundimtare të furnizimeve prej €300. Sa është shuma e Kostos së mallit të shitur që duhet të regjistrohet në pasqyrën e të ardhurave në fund të periudhës?
 - A. €300
 - B. €550
 - C. **€650**
 - D. €850

(1 pikë)

5. Cila nga llogaritë në vijim nuk është pasuri?
 - A. Sigurimi i parapaguar
 - B. Llogaria e arkëtueshme
 - C. **Të hyrat e pafituara**
 - D. Stoqet

(1 pikë)

6. Proçesi i përmbylljes së vitit përfshin:
 - A. Regjistrimin e hyrjeve korigjuese të fundvitit.
 - B. **Transferimin e saldove të të hyrave dhe shpenzimeve tek fitimet e mbajtura.**
 - C. Mbylljen e saldove të llogarive të përhershme.
 - D. Asnjëra nga të mësipërmet.

(1 pikë)

7. Cila nga deklaratat e më poshtme më së miri tregon se pasqyrat financiare janë të besueshme?

- A. Ato janë përgaditur nga menaxher të besueshëm.
- B. Ato janë shfrytëzuar nga tregëtarët e aksioneve.
- C. Ato janë audituar nga auditor të besueshëm.
- D. Ato janë të sakta dhe të lira nga paragjykimet.**

(1 pikë)

8. Kthimet dhe lejimet nga shitja janë kontra llogari të shitjeve dhe normalisht kanë saldo debitore.

- A. E saktë**
- B. E pasaktë

(1 pikë)

9. Burimet që zotërohen nga biznesi quhen:

- A. Të hyra.
- B. Ekuiteti i pronarëve.
- C. Detyrime.
- D. Pasuri.**

(1 pikë)

10. Patentat dhe të drejtat autoriale janë:

- A. Pasuri qarkulluese.
- B. Pasuri të patrupëzuara kapitale**
- C. Investime afatgjata.
- D. Të paamortizueshme.

(1 pikë)

11. Si do të klasifikohet një pagesë furnitorit para dërgesës së mallit?

- A. Shpenzim
- B. Shpenzim aktual
- C. Pasuri**
- D. Detyrim

(1 pikë)

12. Cila nga transaksionet e mëposhtme do të ndikoj që pasurit totale të zvogëlohen?

- A. Blerja me para të gatëshme e paisjeve të depos
- B. Pagesa e kredisë afatgjate ndaj bankës**
- C. Blerja e stoqeve me para të gatëshme
- D. Blerja e furnizimeve të zyrës me kredi
- E. Asnjëra nga të më sipërmet

(1 pikë)

13. Ronald Co. i pagoi €3,000 furnitorit që i kishte borxh për blerjet e mallrave në vitin e kaluar. Cila nga deklaratat më së miri e përshkruan këtë transaksion?
- A. Nuk do të ketë ndryshim në gjithsej pasuri, gjithsej detyrime ose gjithsej ekuitet të pronarit.
 - B. Pasuritë do të zvogëlohen për €3,000, nuk do të ketë ndryshim në detyrime dhe ekuiteti i pronarit do të zvogëlohet për €3,000.
 - C. Pasuritë do të zvogëlohen për €3,000, detyrimet do të zvogëlohen për €3,000 dhe nuk do të ketë ndryshim në ekuitetin e pronarit.**
 - D. Pasuritë do të zvogëlohen për €3,000, detyrimet do të zvogëlohen për €3,000 dhe ekuiteti i pronarit do të zvogëlohet për €3,000.

(1 pikë)

14. Shpenzimet e sigurimit për vitin e fundit të kompanisë ishin 180,000 Euro. Nëse parapagimi për sigurim në fund të vitit ishte 22,500 Euro dhe 35,000 Euro ishte në fillim të vitit, sa është vlera e parave të paguara gjatë vitit:
- A. €180,000.
 - B. €192,500.
 - C. €167,500.**
 - D. €215,000.

(2 pikë)

15. Byrek, Inc. raporton gjatë vitit të hyra prej €500,000 dhe gjithsej shpenzime (duke përjashtuar shpenzimin e tatimit në të ardhura) prej €300,000. Nëse Byrek ka normën e tatimit në të ardhura prej 35%, cili është fitimi neto të cilin Byrek do ta raportoj gjatë vitit?
- A. €105,000
 - B. €130,000**
 - C. €200,000
 - D. €300,000

(2 pikë)

16. Kostot mikse janë kostot që:

- A. Rriten sipas volumit të prodhimit
- B. Zvogëlohen sipas volumit të prodhimit
- C. Mbesin të njëjta me ndryshimet në volumin e prodhimit
- D. Përbëhen nga shpenzimet fikse dhe variable**

(1 pikë)

17. Nëse niveli i prodhimit zvogëlohet për 20%, atëher kostot variabile për njësi:

- A. Zvogëlohen për 20%
- B. Zvogëlohen për 25%
- C. Rriten për 25%
- D. Mbesin të njëjta**

(1 pikë)

18. Informatat e mëposhtëme janë nxjerrur nga bilancet e Meta Co. për përgatitjen e pasqyrave financiare për vitin që përfundon më 31, Dhjetor 2017.

<i>Përshkrimi i llogarive</i>	<i>Saldo me datë 31 Dhjetor 2017</i>
Llogarit e arkëtueshme	230,000
Kostoja e mallrave të shitjes	700,000
Stoqet	320,000
Paisjet	480,000
Shpenzimet e zhvlersimit	30,000
Shpenzimet e rrogave	200,000
Llogarit e pagueshme	255,000
Rrogat e pagueshme	20,000
Kredia bankare	100,000
Shitjet	1,500,000
Kapitali	380,000
Shpenzimet tjera operative	390,000
Fitimet e mbajtura	1,480,000

Kërkohet: Përgatitni Pasqyrën e të ardhurave për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2017?

(3 pikë)

Zgjidhje:

Meta Co.

Pasqyrën e të ardhurave

për vitin që përfundon me 31 dhjetor 2017

Shitjet	1,500,000	
KMSH	<u>(700,000)</u>	
Fitimi Bruto	800,000	
Shpenzimet e zhvlersimit	30,000	
	Shpenzimet e rrogave	200,000
Shpenzimet tjera operative	<u>390,000</u>	
Fitimi neto i periudhës		180,000

19. Kostot të cilat nuk ndryshojnë kur ka luhatje në bazën e aktiviteteve njihen si:

- A. Kosto variabile
- B. Kosto për veprime të lira
- C. Kosto fikse**
- D. Kosto të përziera

(1 pikë)

20. Sa njësi të produktit duhet të shiten që të arrihet fitimi prej €10,000, duke supozuar se kostoja variabile është €7 për njësi, kostot totale fikse janë €800, dhe çmimi i shitjes për njësi është €10?

- A. 4,800 njësi
- B. 4,400 njësi
- C. 4,000 njësi
- D. **3,600 njësi**

(2 pikë)

1. Bazuar ne Ligjin Për Shoqëritë Tregtare: Shoqëria tregtare mund të themelohet dhe regjistrohet për çfarëdo qëllimi të ligjshëm dhe mund të kryejë çfarëdo veprimtarie të ligjshme dhe te pa ligjshme.

E saktë

E pasaktë

2. Sipas Ligjit Për Shoqëritë Tregtare një pronar i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar nuk është përgjegjës për borxhet ose detyrimet e shoqërisë vetëm për arsye se është pronar.

E saktë

E pasaktë

3. Sipas Ligjit Nr. 04/L-014 "Për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim", të gjitha bizneset detyrohen ti nënshtrohen audtitimit nga firmat audituese të licencuar mbi kriteret e këtij ligji.

E saktë

E pasaktë

4. Sipas Ligjit Nr. 04/L-014 "Për Kontabilitet, Raportim Financiar dhe Auditim", Shoqëritë tregtare janë të obliguara të ruajnë pasqyrat financiare bashkë me librat ndihmëse në afat prej dhjetë (10) vitesh.

E saktë

E pasaktë

5. Bazuar në sistemin tatimor të Kosovës, ekzistojnë këto tri lloje kryesore të tatimit të cilat një person juridik apo individ mund ti paguaj:

a) Tatimi në fitim, Tatimi për përdorim të automjeteve dhe Tatimi për derivate;

b) Tatimi në të ardhurat e korporate, Tatimi në të ardhura personale dhe TVSH.

6. Sipas Ligjit Për Administratën Tatimore dhe Procedurat, Librat dhe regjistrimet minimale që duhet mbaj një biznes me qarkullim vjetor bruto deri në 50,000, apo më pak janë: libri i blerjes; libri i shitjes; libri i arkës.

E saktë

E pasaktë

7. Sipas Ligjit Nr. 03/L-222 Për Administratën Tatimore dhe Procedurat renditja e pagesave tek tatimpaguesit nga shpenzimet e mbledhjes e deri te interesi bëhet sipas vullnetit te vet tatimpaguesit:

E saktë

E pasaktë

8. Bazuar ne Ligjin Për Administratën Tatimore dhe Procedurat, një tatimpagues mundet të dorëzojë një ndryshim deklarate tatimore nëse ai ose ajo më vonë zbulon gabim në deklaratën tatimore të cilën e ka dorëzuar tashmë. Afati për të dorëzuar një ndryshim deklarate është jo më vonë se katër (4) vjet pas datës obligative kur deklarata është dorëzuar fillimisht.

E saktë

E pasaktë

9. Sipas Ligjit Për Administratën Tatimore dhe Procedurat, çdo shumë e tatimit e paguar mbi shumën e detyrimit tatimor, me kërkesën e tatimpaguesit do të kreditohet ndaj detyrimit aktual të tatimpaguesit për çdo detyrim tjetër tatimor dhe kontribute pensionale.

E saktë

E pasaktë

10. Sipas ligjit nr. 03/L-162 Për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave, një organizatë e regjistruar si organizatë jo qeveritare sipas Legjislacionit që rregullon regjistrimin dhe funksionimin e OJQ-ve, në Kosovës do të konsiderohet tatimpagues.

E saktë

E pasaktë

11. Sipas ligjit nr. 05/L-029 Për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave, çdo humbje nga shitja apo këmbimi i pasurisë në mes të personave të lidhur konsiderohet shpenzim i pa zbritshëm.

E saktë

E pasaktë

12. Sipas ligjit nr. 05/L-029 Për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave, blerja e një pasurie për çmimin prej 1,000 euro ose më pak do të lejohet si shpenzim rrjedhës.

E saktë

E pasaktë

13. Sipas Ligjit te nr . 03/L-162 Për Tatimin në të Ardhurat e Korporatave shuma e humbjes tatimore e përcaktuar sipas këtij neni, mund të bartet deri në gjashtë (6) vite të njëpasnjëshme tatimore dhe është e disponueshme si zbritje ndaj çfarëdo të ardhure për ato vite.

E saktë

E pasaktë

14. Sipas ligjit nr.03/L-161 për Tatimin në të Ardhurat Personale, Tatimpaguesit janë: Personat fizikë rezident dhe jo rezident; Ndërmarrja personale afariste dhe Ortakëritë.

E saktë

E pasaktë

15. Sipas Ligjin nr .05/L-028 Për Tatimin në të Ardhurat Personale, fitimet kapitale që rezultojnë nga shitjet e pasurive kapitale, duke përfshirë pasurinë e tundshme, të patundshme dhe letrat me vlerë nuk konsiderohen të ardhurat të tatueshme.

E saktë

E pasaktë

16. Sipas Ligjin nr .05/L-028 Për Tatimin në të Ardhurat Personale, edhe pagat e personave me nevoja të veçanta, siç parashihet me ligjet përkatëse për këto kategori janë të ardhura të tatueshme.

E saktë

E pasaktë

17. Sipas ligjit të Tvsh, çdo person është i obliguar që të regjistrohet për Tvsh nga momenti i kalimit të qarkullimit prej tridhjetëmijë Euro (30.000€), brenda vitit kalendarik dhe duhet të njoftojë ATK-në brenda pesëmbëdhjetë (15) ditëve kalendarike prej momentit kur ka lindur obligimi për regjistrim.

E saktë

E pasaktë

18. Detyrimi për ngarkesë me TVSH për mallra dhe shërbime lind varësisht se cili nga tri momentet që ndodh i pari: pranimi i parasë, furnizim i mallit apo shërbimit dhe lëshimi i faturës në lidhje me furnizimin e mallit apo shërbimit.

E saktë

E pasaktë

19. Sipas ligjit të TVSh-se, nëse personi brenda vitit kalendarik tejkalon qarkullimin prej pesëdhjetëmijë euro (50.000€) kërkohet që të regjistrohet për TVSH.

E saktë

E pasaktë

20. Sipas ligjit të TVSH-së, TVSH-ja ngarkohet sipas normës standarde 16% dhe normës së reduktuar 8%.

E saktë

E pasaktë

21. Sipas ligjit të Tvsh-së bizneset e huaja duhet të regjistrohen në regjistrin e detyrueshëm të Tvsh-së nga momenti i fillimit të aktivitetit të tyre në territorin e Kosovës.

E saktë

E pasaktë

22. Sipas Ligjit mbi Pensionet në Kosovë, për të gjitha kategoritë e personave të vetëpunësuar, minimumi i tremujorit të kontributeve do të jetë tridhjetë përqind (30%) të pagesës Minimale.

E saktë

E pasaktë

23. Sipas Ligji të Punës për punët gjatë natës pagesa shtesë bëhet 30% më e lartë se në orët e zakonshme të punës.

E saktë

E pasaktë

24. Sipas Ligjit mbi Pensionet në Kosovë, maksimumi i lejuar për pagesën e kontributit pensional punëdhënës i punësuar është 1/3 e pagës.

E saktë

E pasaktë

25. Sipas Ligjit të Punës, nuk konsiderohet diskriminim, çdo dallim përjashtim ose dhënie e përparësisë, përkitazi me ndonjë vend të caktuar pune, në bazë të kriterëve të caktuara që kërkohen për atë vend pune.

E saktë

E pasaktë

1. Tregoni cilët janë palët e interesuara (grupet ose individët), interesat e të cilëve ndikohen drejtëpërdrejtë prej aktiviteteve të një firme ?

- A. Pagat e punonjësve
- B. Kapitali aksionar i korporatës
- C. Të pagueshmit tregtarë (furnitorët)**
- D. **Huadhënësit**

(2 pikë)

2. Cilat nga pohimet e mëposhtme e përshkruajnë më së miri kontabilitetin menaxherial (krahasuar me kontabilitetin financiar)?

- A. Kontabilistët ofrojnë informacione të përdorura nga palët e brendshme.**
- B. Formati i pasqyrave financiare të publikuara përcaktohet sipas ligjit dhe standardeve kontabël.
- C. Pasqyrat e përgaditura mund të fokusohen mbi një çështje specifike të aktiviteteve të një firme.**
- D. Pasqyrave financiare paraqesin një pasqyrë historike të veprimtarive të kaluara.

(2 pikë)

3. Në një mjedis ekonomik për bizneset, objektivat ekonomike të ndjekura prej qeverisë së një vendi janë :

- A. Rritja ekonomike**
- B. Pjesa e tregut të bizneseve
- C. Punësimi i plotë**
- D. Maksimizimi i fitimit të bizneseve

(2 pikë)

4. Karakteristikat e normave të interesit pse ekzistojnë një numër i madh i normave të interesit janë :

- A. Afati i ripagimit të kredisë**
- B. Të adhurat e gjeneruara nga biznesi që merr kredi
- C. Likuiditeti i biznesit që merr kredi
- D. **Madhësia e kredisë ose depozitës**

(2 pikë)

5. Cili nga pohimi më poshtë paraqet përkufizimin e kapitalit qarkullues ?

- A. Diferenca në mes të Pasurive afatgjatë dhe Kapitalit të biznesit.
- B. Diferenca në mes Pasurive afatshkurtëra dhe Detyrimet afat - shkurtra.**
- C. Diferenca në mes Pasurive qarkulluese minus stoqet dhe Detyrimet afat - afatgjata.
- D. Diferenca në mes të Pasurive afatgjatë dhe Pasurive qarkulluese plus detyrimet afat - shkurtra.

(2 pikë)

Pjesa 3 – Menaxhmenti financiar

Crumbullaksoni përgjigjet e sakta! (Mund të ketë më shumë se 1 përgjigje të saktë)

6. Menaxhimi i kapitalit qarkullues ka të bëjë me menaxhimin e stokeve, llogarive të arkëtueshme, llogarive të pagueshme dhe parasë së gatshme.

E saktë

E pasaktë (1 pikë)

7. Sasia e Porosise Ekonomike (SPE) është sasia e stokeve që duhet të porositet për të minimizuar koston e blerjes së një artikulli të stokeve. Cilat janë kostot relevante të blerjes së stokeve?

A. Kostot e punonjësit të magazinës

B. Kostot e agjentit të shitjes

C. Kosto e mbajtjes dhe mungesës së stokeve

D. **Kostot e prokurimit për porositje dhe marrje në dorëzim të stokeve** (2 pikë)

8. Cilat janë llojet e qasjeve për menaxhimin e kapitalit qarkullues që bizneset mund të aplikojnë dhe duhet të marrin vendime për sa i takon faktit se cilat janë rreziqet më të rëndësishme që kanë të bëjnë me kapitalin qarkullues ?

A. Qasja konservative

B. Qasja mesatare

C. Qasja e industrisë

D. Qasja e prodhimit

E. Qasja e shlyrjes së obligimeve bankare

F. **Qasja agresive** (2 pikë)

9. Buxheti i kapitalit është procesi i identifikimit, analizimit dhe zgjedhjes së projekteve të investimeve, kthimet prej të cilëve pritet të zgjasin:

A. vetëm gjashtë muaj

B. më pak se një vit

C. më shumë se një vit

D. më shumë se tre vite por jo më shumë se pesë vite (2 pikë)

10. Cili është definicioni që tregon se çka paraqet Neto Vleres se Tanishme (NVT), pra NVT paraqet diferencën në mes të:

A. Vlerës së Tanishme (VT) të rrjedhave të ardhshme të parasë dhe Vlerës së Ardhshme (VA) të rrjedhave të parasë së projektit

B. Vlerës së Tanishme (VT) të rrjedhave të ardhshme të parasë dhe Investimit fillestar (IF) të parasë së projektit

C. Vlerës së Ardhshme (VA) e rrjedhave të parasë dhe Vlerës së Tanishme (VT) të rrjedhave të ardhshme të parasë së projektit

D. Vlerës së Ardhshme(VA) e rrjedhave të parasë dhe Investimit fillestar (IF) të rrjedhave të parasë së projektit së projektit (2 pikë)

Pjesa 3 – Menaxhmenti financiar

Rrumbullaksoni përgjigjet e sakta! (Mund të ketë më shumë se 1 përgjigje të saktë)

11. Kompania “ABC” LLC posedon mjete të lira financiare në njërin nga bankat komerciale vlerën prej 40,000.00 euro. Ajo dëshiron të afatizojë shumën e njëjtë prej datës 01.01.2017 me normën e interesit të ofruar nga banka. Nëse norma e kthimit/skontimit është 5%, llogaritni vlerën e ardhshme të këtyre mjeteve nëse ato investohen për 3 vite?

$$Vlera e ardhshme (VA) = Vlera e tanishme \times (1 + r)^n =$$

$$VT = 40,000 \times (1 + 0.10)^3 = 46,305.00 \text{ euro}$$

(2 pikë)

12. Kompania ABC përdorë SPE për menaxhimin e stoqeve për të pëcaktuar sasinë optimale/ekonomike të një mandat blerjeje për kërkesat vjetore të saj. Kërkesa për një artikull është 20,000 njësi në vit, dhe është pothuajse e njëtrajtshme gjatë vitit. Shpenzimet e prokurimit për dhënia e një porosie [mandat – pagese] kushton 25 euro, dhe mbajtja e një njësie për një vit kushton 0.50 euro. Sa është madhësinë e porosisë e cila minimizon kostot e stoqeve (SPE) për ABC?

$$SPE = \sqrt{\frac{2C \times D}{Ch}} =$$

$$SPE = \sqrt{\frac{2 \times 25 \times 20000}{0.5}} = 1,414.21 \sim 1,415$$

(2 pikë)

13. Bazuar ne informatat perkatese te projekteve kapitale me poshte te gjendet periudha e shlyerjes/kthimit ne vite per secilin projekt?

Projekti 1	Projekti 2	
Investimi kapital	100,000	80,000
Fitimet para zhvlerësimit		
Viti 1	70,000	30,000
Viti 2	- 10,000	20,000
Viti 3	40,000	20,000
Viti 4	20,000	20,000
Viti 5	20,000	- 10,000

Periudha e kthimit (Projekti 1): 3 vite

Periudha e kthimit (Projekti 2): 3.5 vite

(2 pikë)

1. Kur një auditor kërkon dëshmi lidhur me pronësinë e pasurive themelore të regjistruara në librat e klientit, cili nga pohimet e mëposhtme të menaxhmentit është i përfshirë?

- A. Vlerësimi ose alokimi (shpërndarja)
- B. Ekzistenca ose ndodhja.
- C. Përbushja (kompletimit).
- D. Të drejtat dhe obligimet.**

(2 pikë)

2. Atëherë kur pasqyrat financiare në tërësi janë çorientuese për shkak të trajtimit kontabël të një zëri i cili nuk është në përputhje me SNK ose SKK, cila nga modifikimet e mëposhtme më së miri e përshkruan se çka do të kërkohet?

- A. Një opinion me rezervë (vetëm).
- B. Një opinion mohues (vetëm).
- C. Një opinion i kundërt (vetëm).**
- D. Një opinion mohues ose një opinion me rezervë.

(2 pikë)

3. Cili është objektivi i përgjithëm i auditimit të pasqyrave financiare?

- A. Të zbulojë deklaratat e gabuara materiale në pasqyrën e pozitës financiare, pasqyrën e të ardhurave dhe paqyrën e rrjedhës së parasë së gatshme të entitetit
- B. Të siguroj dëshmi të mjaftueshme dhe të duhura.
- C. Të shpreh një opinion të duhur se nëse pasqyrat financiare prezantojnë në mënyrë të drejtë, sa i përket materialitetit, pozitën financiare, rezultatin e veprimtarisë, dhe rrjedhën e parasë së gatshme të entitetit.**
- D. Të reduktojë rrezikun nga biznesi.

(2 pikë)

4. Cili është lloji më i besueshëm i dëshmisë së dokumentuar të auditimit që një auditor mund ta marrë (siguroj)

- A. Konfirmimet e pranuar direkt nga palët e treta.**
- B. Ekzaminimi fizik nga auditori.
- C. Dokumentet interne të kompanisë.
- D. Dëshmitë e dokum,entuar të llogaritura nga auditori prej shënimeve të kompanisë.

(2 pikë)

5. Nga pikëvështrimi i auditorit, kur është më e pranueshme të bëhet numrimi i stoqeve para fundit të vitit?
- A. Kur kontrolli i brendshëm është i dobët.
 - B. Kur stoqet lëvizin ngadalë.
 - C. Kur mbahen regjistrimet e sakta të stoqeve sipas sistemit të vazhdueshëm.**
 - D. Kur ekzistojnë shumat e mëdha të stoqeve që mbahen në konsignacion.
- (2 pikë)
6. Nëse menaxhmenti refuzon të ofrojë autorizimet e shkruara të cilat auditori beson se janë esenciale, cila nga të mëposhtmet është e duhur?
- A. Pa bërë asnjë punë shtesë, auditori duhet të lëshojë një opinion pa rezervë.
 - B. Auditori duhet të mbështetet në dëshmi gojore lidhur me çështjen si bazë për opinion pa rezervë.
 - C. Auditori duhet të lëshoj një opinion mohues për shkak të refuzimit të menxhmentit.**
 - D. Refuzimi i klientit nuk përbën limitimin e fushëveprimit; për këtë arsye, auditorit nuk i nevojitet të modifikoj opinionin.
- (2 pikë)
7. Gjatë kryerjes së testeve të pavarura të hollësive gjatë një auditimi, auditori ka përcaktuar se rezultati i mostrës e mbështet konkludimin se saldo e regjistruar e llogarisë është e keqpohuar materialisht. Në fakt, ajo nuk ishte e keqpohuar. Kjo situatë e ilustron rrezikun e:
- A. Refuzim të gabuar.**
 - B. Pranim të gabuar.
 - C. Vlerësimin e rrezikut të kontrollit si shumë të lartë.
 - D. Vlerësimin e rrezikut të kontrollit si shumë të ulët.
- (2 pikë)
8. Një kontroll që siguron se huaja afatgjatë është inicuar në mënyrë të duhur nga individët e duhur adreson pohimin e :
- A. Ndodhjes.
 - B. Klasifikimit.
 - C. Plotësisë.
 - D. Ekzistencës.**
- (1 pikë)
9. Auditorëve të jashtëm i referohemi si “të jashtëm” sepse
- A. Ata nuk janë punonjës të entitetit që auditohet.**
 - B. Ata i raportojnë shfrytëzuesve jashtë entitetit që auditohen.
 - C. Ata paguhen nga palët jashtë entitetit që auditohet.
 - D. zyrat e tyre nuk janë në vendin e biznesit të entitetit.
- (1 pikë)

Pjesa 4 – Auditim

Crumbullaksoni vetëm një përgjigje të saktë!

10. Gjurmimi i një mostre të dëftesave të pagesës (dokumenti burimor) deri te regjistrimet në ditarin e inkasimeve teston cilin nga pohimet për parane?

- A. Ndodhjen.
- B. Plotësinë.**
- C. Autorizimin.
- D. Prerjen.

(1 pikë)

11. Cila nga situatat në vijim nuk paraqet mundësi për të kryer mashtrim?

- A. Transaksione domethënëse në mes të palëve të ndërlidhura.
- B. Marrëdhënia e auditorit me menaxhmentin është e tendosur.**
- C. Menaxhmenti është i dominuar vetëm nga një person.
- D. Pasqyrat financiare përmbajnë një vlerësim (çmuarje) kontabël që është shumë subjektive.

(1 pikë)

12. Përcaktimi se çka është materiale në kontekstin e auditimit varet nga:

- A. Rregulloret dhe ligjet në fuqi.
- B. Gjykimi profesional i auditorit.**
- C. Përqindja e përcaktuar nga profesioni.
- D. Asnjëra nga më sipër.

(1 pikë)

13. Auditori ka krahasuar marzhën e fitimit bruto të vitit aktual me atë të vitit të kaluar për të përcaktuar nëse kosto e mallrave të shitur është e arsyeshme. Çfarë lloji të procedurave të auditimit janë kryer?

- A. Teste të transaksioneve.
- B. Procedura analitike.**
- C. Teste të kontrollit.
- D. Teste të detajeve (hollësive).

(1 pikë)

14. Fletët e punës i takojnë:

- A. Auditorit.**
- B. Klientit.
- C. Këshillit për raportim financiar.
- D. Shoqatës së kontabilistëve dhe auditorëve.

(1 pikë)

15. Pasqyrat financiare janë përgjegjësi e:

- A. Menaxhmentit.
- B. Auditorit.
- C. Aksionarëve.
- D. Kreditorëve.

(1 pikë)

16. Cila nga të mëposhtmet NUK është kërcënim për pavarësinë?

- A. Interesi vetanak.
- B. Njohja-familjariteti me klientin.
- C. Vetë-rishikimi.
- D. Konfidencialiteti.

(1 pikë)

17. Niveli i sigurisë i dhënë nga një auditim për zbulimin e anomalive materiale referohet në:

- A. Siguri absolute.
- B. Siguri e nivelit të lartë.
- C. Siguri negative.
- D. Siguri të arsyeshme.

(1 pikë)

18. Cilat nga të mëposhtmet paraqsin dëshmitë që zakonisht janë më së paku të besueshme?

- A. Procedurat analitike
- B. Dokumentimi.
- C. Vëzhgimi.
- D. Konfirmimi.

(1 pikë)